

L I G J
Nr.9497, datë 20.3.2006

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SHQIPTARE TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Objekt i këtij ligji është krijimi i Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve, përcaktimi i fushës së veprimtarisë dhe i parimeve e rregullave të përgjithshme për organizimin dhe funksionimin e kësaj Agjencie.

2. Funksionimi dhe veprimtaria e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve përcaktohen në statut, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura dhe organika përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Neni 2

Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve (ASHBI), që më poshtë në ligj do të quhet thjesht "Alb-Invest", është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me seli në Tiranë dhe e ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Objekte të veprimtarisë së Alb-Invest-it janë:

- a) zbatimi i politikave dhe strategjive, zhvillimi i programeve dhe projekteve, në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat;
- b) studimi, kërkimi, analizat dhe konkluzionet për klimën e biznesit;
- c) nxitja, tërheqja dhe mbështetja e investimeve të huaja, në përputhje me përparësitë e politikës së Qeverisë;
- ç) identifikimi i mundësive për investime në Shqipëri dhe promovimi i tyre;
- d) nxitja e prodhimit vendas dhe e produkteve për eksport për në tregjet e huaja;
- dh) nxitja dhe mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- e) zhvillimi i veprimtarive të promocionit, brenda dhe jashtë vendit, në funksion të përmirësimit të imazhit të Shqipërisë;
- ë) dhënia e asistencës për lehtësimin e investimeve, vendase dhe të huaja, për shoqëritë eksportuese dhe sigurimi i të dhënave dhe i shërbimeve mbështetëse për investitorët dhe eksportuesit;
- f) bashkëpunimi me institucionet publike, financiare, organizatat e biznesit, të vendit dhe të huaja, për identifikimin e barrierave të zhvillimit të biznesit;
- g) botimi i të dhënave zyrtare për investimet, eksportet dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- gj) dhënia e ekspertizës organeve të pushtetit qendror, vendor dhe investitorëve të huaj për fizibilitetin e investimeve.

Neni 4

Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, janë të detyruara të bashkëpunojnë me Alb-Invest-

in, të shkëmbejnë të dhëna dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë, për përmbushjen e qëllimeve dhe të funksioneve të veprimtarisë së tij.

Neni 5

1. Alb-Invest-i, në përputhje me ligjin, ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të realizojë të ardhura nëpërmjet shërbimeve që kryen, në funksion të qëllimit dhe fushës së veprimtarisë së vet.
2. Alb-Invest-i nuk lejohet të ushtrojë veprimtari fitimprurëse.
3. Alb-Invest-i përgjigjet me mjetet e veta për detyrimet ndaj të tretëve.

KREU II ORGANET DREJTUESE TË ALB-INVEST-IT

Neni 6

Organet drejtuese të Alb-Invest-it janë:

- a) Këshilli Drejtues;
- b) Drejtori Ekzekutiv.

2. Këshilli Drejtues ka për detyrë të përcaktojë strategjinë, fushat dhe programin e veprimtarive të Alb-Invest-it, të shqyrtojë dhe të miratojë aktet më të rëndësishme për administrimin, organizimin, çështjet financiare dhe buxhetin e tij, mbikëqyrjen dhe kontrollin në vazhdimësi të realizimit të tyre, si dhe të vendosë për çështje të tjera, të parashikuara në ligj ose në statut.

3. Përbërja e Këshillit Drejtues të Alb-Invest-it, mënyra dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të tij caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

1. Drejtimi i veprimtarisë së përditshme dhe përfaqësimi i Alb-Invest-it në marrëdhënie me të tretët, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të statutit të tij, bëhen nga Drejtori Ekzekutiv.

2. Drejtori Ekzekutiv emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

KREU III FINANCAT E ALB-INVEST-IT

Neni 8

Burimet e financimit të Alb-Invest-it janë:

- a) Buxheti i Shtetit, në përputhje me situatën financiare;
- b) donatorë të ndryshëm;
- c) të ardhurat nga shërbimet dhe projektet e realizuara nga vetë ai.

2. Llogaritë e Alb-Invest-it kontrollohen nga ekspertë kontabël të autorizuar.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 9

Në ligjin nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, fjalët “Agjencia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme” zëvendësohen me fjalët “Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve”.

Neni 10

Ligji nr.8877, datë 4.4.2002 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja”, ligji nr.9023, datë 6.3.2003 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve”, si dhe nenet 12 e 13 të ligjit

nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, shfuqizohen.

Neni 11

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe për rregullimin e marrëdhënieve të parashikuara në nenet 1, 6 e 8 të këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4825, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**